

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

URDHËR

**I
PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM
NR 67 DATE 30 . 12 . 1997**

**PËR
MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TE FASHIKUJVE GJATE FAZËS SE
HETIMIT PARAPRAK**

Me qellim, që të mos zvarriten hetimet;

Për t'i krijuar gjykatës kushte normale pune;

Për te realizuar një administrim sa me te mire te akteve
procedurale penale;

Ne mbështetje te nenit 13 te ligjit nr. 7561, date 29,04, 1992 “Për
dispozitat kryesore kushtetuese” dhe nenit 24, pika 4 te Kodit te Procedurës
Penale,

URDHEROJ:

1. Ne të gjitha rastet kur gjate fazës se hetimit paraprak kërkohen
dosjet nga Prokuroria e Përgjithshme ose kur nga vete prokuroritë e rretheve
dërgohen dosjet për studim, ne Prokurorinë e Përgjithshme do të dërgohet kopja
e pare e dosjes, ndërsa me kopjen tjetër te saj do të vazhdoje hetimi.

2. Kur ne gjykate dërgohen materialet për vleftësimin dhe caktimin e
masave te sigurimit ose kur ushtrohet apel, apel kundërshtues ose rekurs kundër
masave te sigurimit, ne gjykate do të dërgohet kopja e pare e dosjes, ndërsa me

kopjen tjetër do të vazhdoje puna.

3. Kur gjate fazës se hetimit paraprak dërgohet fashikulli ne gjykate por njëkohësisht lind nevoja për ta dërguar materialet edhe ne qendër, ne Prokurorinë e Përgjithshme dërgohet kopja tjetër e dosjes, ndërsa prokuroria e rrethit mban fotokopjen e materialeve për të vazhduar hetimin.

4. Ne të gjitha rastet kur gjate fazës se hetimit paraprak dërgohen fashikujt ne Gjykate ose ne Prokurorinë e Përgjithshme materialet duhet te jene detyrimisht te lidhura ne dosje dhe te inventarizuara rregullisht.

5. Fashikujt e dërguar ne Prokurorinë e Përgjithshme pas studimit dhe nxjerrjes se urdhrave përkatëse, kthehen sa me pare ne prokuroritë e rretheve por 30 me vone se 1 muaj nga dita e mbërritjes ne qendër.

6. Porsa gjykata ka shqyrtuar kërkesat e prokurorit, apelet, apelet kundërshtues ose rekursat për masat e sigurimit bashke me vendimet tërhiqen menjëherë nga gjykata fashikujt e dërguar.

7. Me zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Hetimit dhe Kontrollit, Drejtoria e veprave penale ushtarake dhe prokuroritë e rretheve.

8. Ky urdhër hyn ne fuqi me 01.01.1998.

PROKURORI I PËRGJITHSHEM

ARBEN RAKIPTI



